



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE
KORÇE
KESHILLI I GJYKATES

Nr. 35 Prot.

Korçë më dt. 11.11.2022

VENDIM

“Për mbyllje procedure pranimit në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive për pozicionin specialist IT dhe punonjës i marrëdhënieve me publikun dhe mediat”

Këshilli i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë në zbatim të Ligjit Nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit Nr.622 datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor” dhe Udhëzimit rr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor” vendos të marrë në shqyrtim në mbledhjen e ditës së sotme përfundimin e procedurës për plotësimin e vendit vakant specialist IT dhe punonjës i marrëdhënieve me publikun dhe mediat.

Me shkresën nr.230 prot. datë 28.10.2022 kancelari ka njoftuar këshillin e gjykatës mbi rezultatet e verifikimit paraprak të kandidatëve për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor për pozicionin Specialist IT dhe punonjës i marrëdhënieve me publikun dhe mediat shpallur më datë 03.10.2022 me shpalljen rr.198/1 prot datë 03.10.2022.

Në përfundim të verifikimit paraprak nga kancelari rezultoi se nuk u paraqit asnjë kandidaturë për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor për pozicionin Specialist IT dhe punonjës i marrëdhënieve me publikun dhe mediat.

Në këto kushte Këshilli i Gjykatës vlerëson se procedura për plotësimin e vendit vakant Specialist IT dhe punonjës i marrëdhënieve me publikun dhe mediat nëpërmjet pranimit në shërbimin civil gjyqësor të shpallur me vendimin nr.28 datë 30.09.2022 të Këshillit të Gjykatës duhet të mbyllet për mungesë aplikimi kandidatësh.

NE KETO RRETHANA KESHILLI I GJYKATES
VENDOSI

1. Të mbyllë procedurën për pranim në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive për pozicionin specialist IT dhe punonjës i marrëdhënieve me publikun dhe mediat në Gjykatën Administrative Shkalla e Parë Korçë për mungesë aplikimi kandidatësh.
2. Vendimi për mbylljen e procedurës të përcillet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të botohet në faqen zyrtare të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë sipas kërkesave të vendimit nr.622 datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
3. U shpall sot më datë 11.11.2022 në Korçë.

ANETAR

ALEKSANDER DINO



KRYETARI

LIGORAO TOSHI



ANETARE

ETLEVA GJAMO

